



Viti i XV-të I Botimit, Nr.1,

Qershor 2023

## MËSIMDHËNIA KREATIVE NDIKON NË VETËAKTUALIZIMIN E NXËNËSVE

Anila Bratja\*, Fotjana Kosta\*\*

\* Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Fakulteti Edukimit, Departamentin e Pedagogjisë

### Përmbledhje

Kreativiteti është tregues i rëndësishëm për suksesin e nxënësve në jetë. Ky studim pati si qëllim të evidentonte marrëdhënien midis kreativitetit dhe vetë-realizimit të nxënësit, si dhe të përcaktonte si ndikojnë aftësitë krijuese në vetrealizimin e nxënësve. Nisur nga kjo, studimi u mbështet në pyetjen kërkimore: “ndikim i kreativitetit në shkallën e vetë-aktualizimit të nxënësve”.

Në këtë studim u përdorën metodat sasiore. Popullata janë nxënësit e klasave të pesta të rrethit të Durrësit, prej së cilës u përzgjedh një kampion prej 298 nxënësish, 48% meshkuj dhe 52% femra. Pyetësi i studimit përbëhej nga dy pjesë; pjesa e parë mat vetaktualizimin e nxënësit, sipas indeksit të vetaktualizimit me 15 tregues, sipas Jones dhe Crandall (1986) dhe pjesa e dytë mat kreativitetin në të nxënë me 16 tregues, sipas Kumar dhe Holman (1997), varianti i shkurtuar.

Nga gjetjet studimore vihet re një marrëdhënie e moderuar midis kreativitetit dhe vetë-realizimit të nxënësve, marrëdhënie kjo e cila spikat më shumë me rritjen e tyre. Në të njëjtën kohë vihet re se aplikimi i teknikave krijuese ndikon pozitivisht në shkallën e vetëpranimit dhe besimit në vetvete. Nisur nga ky studim, rekomandohet që mësuesit të aplikojnë metoda dhe teknika, duke nxitur kreativitetin tek nxënësit, dhe kontribuar në këtë mënyrë për të ardhmen e tyre dhe të vendit.

**Fjalë çelës:** *kreativitet, vetë-realizim, aftësi krijuese, teknika kreative, vetë-pranim.*

### CREATIVE TEACHING INFLUENCES STUDENTS' SELF-ACTUALIZATION

Creativity is an important indicator of students' success in life. The purpose of this study was to identify the relationship between creativity and student self-realization, as well as to determine how creative skills affect student self-actualization. This study was based on its research question, “what was the impact of creativity on the degree of self-actualization of students?”.

In this study, quantitative methods were used. The population was the students of the fifth grade of Durrës, from which a sample of 298 students was selected, 48% males and 52% females. The study questionnaire consisted of two parts; the first part measured the student's self-actualization, according to the self-actualization index with 15 indicators, according to Jones and Crandall (1986) and the second part measured creativity in learning with 16 indicators, according to Kumar and Holman (1997), the shortened version.

A moderate relationship between students' creativity and self-realization is observed. At the same time, it is noted that the application of creative techniques positively affected the degree of self-acceptance and self-confidence. Based on this study, it is recommended that teachers should apply methods and

techniques, to encourage creativity in students, and contribute to their future.

**Key words:** *creativity, self-realization, creative ability, creative techniques, self-acceptance.*

## Hyrje.

### Prezantimi i problemit

Shkolla dhe në veçanti klasa është parë si një kontekst i privilegjuar për promovimin e krijimtarisë në rritjen e socializimit dhe progresin individual. Në kontekstin shkollor mësuesit nuk janë vetëm burim informacioni, por ato gjithashtu veprojnë si model për nxënësit e tyre në lidhje me strategjitë dhe sjelljet. Gjithashtu ata kanë përgjegjësinë për transmetimin e njohurive. Duke ditur se kurrikula mund të jetë një mundësi e synuar për nxitjen e krijimtarisë, mësuesit duhet të jenë ndërmjetësi kryesor midis kurrikulës dhe çfarë praktikohet në klasë, si një element thelbësor për t'i bërë nxënësit më kreativë. Roli që luhet nga mësuesit është jetësor për të ardhmen e shoqërisë. Përgatitja fillestare duhet t'u japë mësuesve të ardhshëm njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të formojnë një bazë të fuqishme për mësimdhënie efektive, dhe zhvillim të vazhdueshëm gjatë gjithë karrierës së tyre (Fullan, 2010:162).

Sipas Zajazi (2003: 476), mësuesi është faktori më i rëndësishëm në procesin e të menduarit. Tekstet, fletoret e punës, programet e planifikuara dhe ushtrimet janë një ndihmë e vlefshme, por jo e mjaftueshme për të nxitur aftësitë mendore të nxënësve. Këtë e bën mësuesi, kur ai ka njohuri për përmbajtjen e lëndës, ashtu edhe për proceset e të menduarit. Kapërcimi i të nxënësve riprodhues dhe kalimi në nxënës krijues, është kyçi i kalimit nga mësimi i trashëguar klasik, në mësimdhënie dhe nxënës moderne, domethënë në nxënës që ka themele të mbështetura në rezultatet e shkencës dhe teknologjisë së mësimt. Ky proces duhet të fillojë në moshë më të hershme të fëmijës. Referuar këtij konteksti, ky studim ka si qëllim të evidentojë mësimdhënien kreative dhe ndikimin e saj në vetërealizimin e nxënësve, duke shtruar pyetjen kërkimore; si ndikon kreativiteti në vetaktualizimin e nxënësve të klasave të pesta të qytetit të Durrësit.


### Korniza Teorike dhe Rishikimi i Literaturës

Krijimi është një proces. Procesi përqendrohet më shumë në nxitjen e frymës krijuese, sesa me rezultatin, sepse ky rezultat është jetëshkurtër, ndërsa frymëzimi zgjat gjithë jetën. Frymëzimi mbështetet në qëndrime, ndërkohë që krijueshmëria është procesi që zhvillon qëndrimet. Me një fjalë, qëndrimi është ai që, së bashku me procesin, nxit ide krijuese të panumërta gjatë gjithë jetës së fëmijës, e më tej. Sipas Beghetto dhe Kaufman (2014), përpara se të diskutohet se si mjediset e të mësuarit mund të ndikojnë në krijimtarinë, është e rëndësishme të përcaktohet çfarë nënkuptohet me kreativitet. Shumica e studiuesve e kanë përcaktuar krijimtarinë me dy elementë kyç që kanë pasur një qendrueshmëri, për më shumë se gjashtë dekada (Barron, 1955; Guilford, 1950; Stein, 1953). Shtylla e parë e këtij përkufizimi është se krijimtaria duhet të përfaqësojë diçka të re ose të ndryshme. Por vetëm risia nuk mjafton; për të qenë kreativ, ekziston gjithashtu një pritshmëri mbi përshtatshmërinë ose dobinë e detyrës/punës. Të dyja këto koncepte janë të nevojshme që diçka të jetë krijuese; Simonton (2012) pohon: Kreativiteti = Originaliteti × Përshtatshmëria. Nëse diçka nuk është e përshtatshme ose jo origjinale, atëherë nuk mund të konsiderohet krijuese.

Kaufman dhe Beghetto (2013) përcaktuan katër nivele të kreativitetit, duke shtuar edhe nivelet mini-c dhe pro-c. Kjo është e rëndësishme nga pikëpamja e punës që duhet bërë me nxënësit për ta nxitur dhe kultivuar kreativitetin, pasi minikreativiteti është i lidhur me nxënien zbuluese, kreativiteti i pakët mund të grumbullohet duke kushtuar vëmendje tek shokët apo mësuesit, pro-krijimtaria lidhet me arritjet në një drejtim apo profesion të caktuar, ndërsa krijimtaria e madhe përfshin arritjet brenda dhe jashtë këtyre kufijve (Sullivan, 2017).

Për Treffinger (1986), nuk ka ende një teori të vetme, unifikuese për krijimtarinë, që përqafohet nga të gjithë studiuesit dhe praktikuesit. Në të vërtetë, duke pasur parasysh kompleksitetin e konstruktit të krijimtarisë dhe shumëllojshmërinë e shfaqjeve të saj në jetën e përditshme, duket e pamundur të ketë pasur ndonjëherë një “teori të përgjithshme”. Megjithatë, gjatë dy dekadave të fundit është bërë progres i rëndësishëm në këtë fushë. Një përparim domethënës ishte analiza e Gowan (1972) për teorinë e krijimtarisë, përmes së cilës u zhvilluan pesë kategori të përgjithshme për klasifikimin e shumë teorive. Kategoritë e Gowan janë përdorur dhe zgjeruar nga të tjerë (p.sh., Treffinger, Isaksen & Firestien, 1982, 1983); përpjekje të tjera të rëndësishme për të sintetizuar teori të ndryshme janë bërë nga Roweton (1972) dhe I. A. Taylor (1976). Korniza specifike për analizimin e qëllimeve dhe objektivave të krijimtarisë janë dhënë gjithashtu nga Davis dhe O’Sullivan (1980), Treffinger dhe Huber (1975) dhe Isaksen dhe Treffinger (1985). Vlera kryesore e këtyre kontributeve ka qenë që të na mundësojnë të jemi më sistematikë në kuptimin, përshkrimin, kategorizimin e teorive dhe përkufizimeve tona. Ashtu siç nuk ekziston një teori e vetme, e pranuar në mënyrë uniforme për krijimtarinë, nuk ka gjithashtu asnjë instrument të vetëm vlerësimi, të pranuar botërisht.

Modeli katër C mund t’i ndihmojë mësuesit të kuptojnë nivelet e shprehjes krijuese si më të përshtatshme për mjedisin e klasës (d.m.th. mini-dhe pak-c)<sup>1</sup> dhe të identifikojnë faktorët kryesorë të nevojshëm për mbështetjen e zhvillimit të krijimtarisë nga një nivel në tjetrin. Referuar trajektorës së kreativitetit, reagimet luajnë rol të rëndësishëm për të ndihmuar që idetë mini-c të dikujt të marrin formë (pra të shfaqen) në kontribute të vogla, që të tjerët mund t’i vlerësojnë si krijuese. Në nivelin pak-c, praktika e qëllimshme është një nga faktorët më të rëndësishëm dhe të nevojshëm për përparimin nga krijimtaria e përditshme në nivelet profesionale të arritjeve krijuese (Ericsson, 1996). Së fundi, në nivelin Pro-c, koha është një nga faktorët më të rëndësishëm në arritjen e statusit legjendar, Big-C. Krijimtaria Big-C, siç ka përshkruar Csikszentmihalyi (1999), përcaktohet në fusha të veçanta (si arti). Krijimtaria Big-C u jepet krijuesve dhe arritjeve krijuese pas kalimit të një kohe të gjatë (Beghetto dhe Kaufman, 2014). Në figurën 1 pasqyrohet trajektorja e zhvillimit të krijimtarisë



**Figura 1.** Trajektorja e zhvillimit të krijimtarisë, e përshtatur, sipas Beghetto and Kaufman (2014)

<sup>1</sup> mini-c, nënkupton mini kreativitet dhe pak-c nënkupton pak kreativitet..

Ahmadi dhe Besançon (2017) pohojnë se faktorët konativ kanë ndikim në kreativitet. Disa mënyra të sjelljes janë identifikuar dhe karakterizuar nga individë krijues. Lubart dhe kolegët (2015) citojnë disa prej tyre, duke përfshirë tiparet e personalitetit, stilet njohëse dhe motivimin. Copley (2009) prezantoi një listë të tipareve të përbashkëta të personalitetit të përfshira në potencialin krijues të individit si pavarësia, hapja ndaj përvojës, fleksibiliteti dhe toleranca e paqartësisë (1987, 2010). Aftësia për të prodhuar ide të reja quhet potencial krijues. Potenciali krijues i referohet mundësive të individit duke marrë parasysh kapacitetin njohës, personalitetin, motivimin dhe mjedisin. Duke marrë parasysh zhvillimin e potencialit krijues, ai mund të ndryshojë me kalimin e kohës, dhe potenciali do të ndryshojë në varësi të fushës dhe detyrës.

Vetë-aktualizimi është një koncept i lidhur ngushtë me hierarkinë e nevojave të Maslow dhe ky i fundit e përdori për realizimin e potencialit njerëzor. Sipas tij, kur këto nevoja shfaqen, motivimi i njeriut nuk ndalon, por rritet duke kërkuar një realizim të mëtejshëm. Vetë-realizimi nuk është vetëm një gjendje përfundimtare, por është gjithashtu procesi i realizimit të potencialeve në çdo kohë, dhe masë. Vetë-realizim do të thotë të përdoret IQ-ja, duke përdorur inteligjencën. Kjo nuk do të thotë të bësh domosdoshmërisht diçka të largët, por mund të nënkuptojë të djsitesh, të studiosh, të merresh me matematikën ose fizikën apo të ushtrohesh në një tastierë piano. Vetërealizim do të thotë të punosh për të bërë mirë, atë që dëshiron të bësh (Maslow, 1965).

Më tej, Maslow (1971), trajton konceptin trans-personal, duke ngritur pyetjet: “Cilat janë momentet që japin goditjen më të madhe, kënaqësinë më të madhe? Cilat janë momentet e mëdha? Cilat janë momentet e shpërblimit që e bën punën dhe jetën të vlefshme?” Sikurse Hartman (1967), Maslow e gjen përgjigjen tek “vlerat e brendshme”, si; e vërteta, mirësia, bukuria, përsosmëria, thjeshtësia, eleganca, etj. Individë të tillë, që shkojnë përtej vetërealizimit karakterizohen nga një model sjellje; janë autentikë, të sinqertë dhe sjellin të ardhmen në të tashmen, pra çfarë duhet të jetë, është.

Në këtë kontekst, është me interes puna e Goleman mbi inteligjencën emocionale. Goleman (2006: 64, 66) pohon se inteligjenca emocionale dhe IQ-ja nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Ato thjesht janë të ndryshme. Që të gjithë e përziejnë intelektin me aftësitë emocionale. Njerëzit me IQ të lartë dhe inteligjencë emocionale të varfër, pavarësisht stereotipeve, janë të rrallë. Në të vërtetë vihet një lidhje e lehtë mes IQ-së dhe aspekteve të inteligjencës emocionale. Nëse një person zotëron si inteligjencën konjiktive, ashtu dhe atë emocionale, këto cilësi shkrihen. Megjithatë, po t'i vëmë në peshore të dyja, është inteligjenca emocionale që na përkufizon më shumë si njerëz.

Sipas Rivero (2002), vënia në praktikë e edukimit për vetë-aktualizim do të përfshijë një mjedis mësimi që promovon dhe mbështet të nxënësit kreativ – nëpërmjet të mësuarit digresiv, të mësuarit zbulues, dhe integritit të punës me lojën, pavarësisht nëse mësimi parësor i fëmijës ndodh në shtëpi ose në shkollë. Zbulimi i mënyrës se si të sigurohet ky mjedis është një shqetësim i përbashkët si për edukatorët në klasë, ashtu edhe për prindërit në shtëpi. Të rriturit që punojnë me fëmijët mund të ushqejnë të mësuarit krijues, duke përqafuar dikotomitë; duke vlerësuar kreativitetin parësor, duke lejuar të mësuarit divergjent e zbulues, si dhe duke inkurajuar integrimin e punës me lojën. Në ditët e sotme, me përparësinë që ka marrë teknologjia e inforacionit, të nxënësit përmes lojrave kompjuterike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive krijuese, si dhe në aspektet vetrealizuese të tyre. Burlson (2005) konkludon se sot ekziston mundësia për të përdorur të kuptuarit tonë të psikologjisë njerëzore dhe aftësive në inteligjencën artificiale për të krijuar një sistem hibrid sinergjik të të mësuarit njeri-kompjuter. Edukatorë dhe psikologë të shquar pajtohen se të mësuarit përmirësohet kur ndiqet si një pasion krijues dhe vetë-aktualizues. Imajinata, vetëdija metakognitive dhe zhvillimi i perspektivave të shumta janë thelbësore për të kuptuarit e thellë. Kjo çon në zhvillimin e strategjive të brendshme metakognitive të përdoruesve për të mbështetur dhe lehtësuar mësimin, kreativitetin dhe vetërealizimin.

## Metodologjia e Studimit

Në këtë studim janë përdorur metoda të përziera; sasiore dhe cilësore. Është aplikuar një pyetësor i strukturuar për të matur mësimdhënien kreative (variabël i pavarur) dhe vetaktualizimin (variabël i varur). Për të mbledhur të dhënat sasiore parësore të variablave të pavarur dhe të varur, ky instrument matës është plotësuar nga nxënësit e klasave të pesta të rrethit të Durrësit. Pyetësi përbëhet nga dy shkallë; shkalla e parë mat vetaktualizimin e nxënësit, sipas indeksit të vetaktualizimit nga Jones dhe Crandall (1986), dhe shkalla e dytë mat kreativitetin në të nxënë me 16 tregues, nga Kumar dhe Holman (1997), varianti i shkurtuar.

Indeksi i Vetë-aktualizimit të Jones dhe Crandall 1986, përbëhet nga 15 tregues (pohime), i përbërë nga 4 faktorë: Vetëbesimi, Vetëpranimi, Besimi dhe Autonomia

Pjesa e dytë e pyetësorit i adresohet nxënies kreative, me 16 tregues gjithsej, sipas variantit të shkurtuar të autorëve, Kumar dhe Holman (1997). Faktorët për këtë shkallë të pyetësorit janë: besimi tek aftësitë krijuese, përdorimi i teknikave kreative, ndërveprimi me të tjerët dhe përdorimi i shqisave.

Shkalla e përdorur është ajo Likert me 4 shkallë matëse; 1) aspak dakord, (2) nuk jam dakord, (3) dakord, (4) shumë dakord. Gjithashtu pas plotësimit të pyetësorit nga nxënësit janë idejuar edhe 2 pyetje të hapura si; “Cilët janë faktorët që nxisin kreativitetin tek nxënësi?” dhe “Si ndikon kreativiteti në vetaktualizimin e nxënësit?” përmes aplikimit të fokus-grupit me mësuesit e klasave të pesta, po në qytetin e Durrësit.

### Pjesëmarrësit:

Popullata e këtij studimi ishin nxënësit e klasave të pesta, të rrethit të Durrësit.

Gjithsej në studim morën pjesë 298 nxënës; 48% meshkuj dhe 52% femra. Gjithashtu, pjesëmarrës në studim ishin edhe 10 mësuesit e fokus-grupit.

## Rezultatet e Studimit

Bazuar në problematikën studimore dhe për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore, pohimet u grupuan sipas faktorëve, për secilën shkallë të pyetësorit.


### Faktori i vetëbesimit

: Nga të dhënat e marra në terren, rezulton se; për pohimin “unë ndjej që mund të bëj atë çfarë të tjerët presin prej meje”, 9% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 21% nuk janë dakord, 54% janë dakord dhe 16% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “është gjithmonë e rëndësishme që të tjerët të miratojnë çfarë unë bëj”, 14% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 39% nuk janë dakord, 27% janë dakord dhe 20% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “unë i shmang përpjekjet për të analizuar dhe thjeshtëzuar çështje komplekse”, 27% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 33% nuk janë dakord, 34% janë dakord dhe 6% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “është më mirë të jesh vetvetja sesa të jesh shumë i njohur”, 2% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 4% nuk janë dakord, 34% janë dakord dhe 60% e tyre janë shumë dakord.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat si vijon:

## Vetëbesimi

- Unë ndjej që mund të bëj atë çfarë të tjerët presin që unë mund të bëj.
- Është gjithm onë e rëndësishme që të tjeret të miratojnë atë çfarë unë bëj.
- Unë i shm ang përjekjet për të analizuar dhe thjeshtëzuar çështje komplekse.
- Është më mirë që të jesh vetvetja sesa të jesh shumë i njohur.
- Unë nuk kam asnjë mision specifik në jetë ndaj të cilit të ndihem e dedikuar.




Grafiku 1. Vetëbesimi

### Faktori i vetëpranimit:

Nga të dhënat e marra në terren, rezulton se; për pohimin “unë nuk i pranoj dobësitë e mia”, 34% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 27% nuk janë dakord, 24% janë dakord dhe 15% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “unë e kam frikë dështimin”, 33% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 26% nuk janë dakord, 29% janë dakord dhe 12% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “unë jam i/e shqetësuar nga frika e të qëniti i papërshtatshëm”, 32% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 32% nuk janë dakord, 29% janë dakord dhe 7% e tyre janë shumë dakord.

## Vetëpranimi


- Unë nuk i pranoj dobësitë e mia.
- Unë e kam frikë dështimin.
- Unë jam i/e shqetësuar nga frika e të qëniti i papërshtatshëm.



Grafiku 2. Pranimi vetes

**Aftësitë krijuese:**

Nga të dhënat rezultojnë se; për pohimin “unë e konsideroj veten si një person kreativ”, 8% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 17% nuk janë dakord, 38% janë dakord dhe 37% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “unë jam i/e angazhuar në një lloj pune kreative me një bazë të rregullt”, 14% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 15% nuk janë dakord, 50% janë dakord dhe 21% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “unë praktikohem të jem kreativ”, 13% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 13% nuk janë dakord, 43% janë dakord dhe 31% e tyre janë shumë dakord. Për pohimin “kreativiteti im vjen nga vet-disiplina”, 12% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk janë aspak dakord, 6% nuk janë dakord, 57% janë dakord dhe 25% e tyre janë shumë dakord. Të dhënat pasqyrohen grafikisht, si më poshtë;



**Grafiku 3.** Aftësitë krijuese

**Të dhëna cilësore:**

Referuar opinionit të mësuesve janë marrë këto të dhëna cilësore:

Faktorët që nxisin kreativitetin tek nxënësi

- Faktorët që nxisin kreativitetin e nxënësve janë: punët në grupe në klasë, talenti i vetë fëmijes si dhe familja e tyre.
- Në procesin mësimor në lëndë të ndryshme, mësuesja përzgjedh metoda të ndryshme për të bërë më interesante orën e mësimin : si puna në grupe, puna individuale, projekte të ndryshme apo në lëndën e gjuhës shqipe tema të ndryshme që kanë lidhje dhe me fantazinë e tyre.

- Organizimi i orës së mësimimit në mënyrë argëtuese, organizimi i aktiviteteve sportive, projekte, ekskursioneve etj. Gjithpërfshirja e nxënësve në orën e mësimimit dhe në aktivitete pavarësisht nga niveli, raca dhe gjendja ekonomike.

- Punët krijuese, projektet aktivitetet, lojrat, studimet mësimore.

Me futjen e kurrikulës së re është nxitur më shumë kreativiteti i nxënësve.

Si ndikon kreativiteti në vetaktualizimin e nxënësit?

-Ndikon pozitivisht sepse nxënësi bëhet më i përgjegjshëm dhe ka vetëbesim.

- Një nxënës i vetërealizuar është një nxënës që ka arritur në pikën më të lartë të kreativitetit sepse është gjithmonë aktiv në gjithçka ndodh, në shkollë dhe jashtë saj.

- Ndikon shumë mirë, rrit besimin në vetëvete, motivimin në të nxënë dhe rrit nivelin e përgjegjshmërisë.

- Kreativiteti krijon tek nxënësi vetëbesim dhe dëshirë për të marrë iniciativa dhe për të kërkuar përgjigje.

- Kreativiteti ndikon pozitivisht te fëmijët: rrit vetëbesimin te fëmija, rrit komunikimin me njëri-tjetrin, ndikon në vlerësimin e punës, ndikon në marrjen e iniciativave për aktivitete të ndryshme. Vetëm në këtë mënyrë nxënësi merr përgjegjësinë për të bërë çdo gjë në mënyrë të saktë, me kënaqësi dhe pa u lodhur.

## Diskutime, përfundime dhe rekomandime

### Si ndikon besimi dhe aftësitë krijuese në vetë-realizimin e nxënësve?

Nga analiza e të dhënave rezulton se 75% e të anketuarve pohojnë se kanë aftësi krijuese, 71% pohojnë se janë të angazhuar në veprimtari krijuese, 48% e tyre pohojnë pasjen e ideve, 74% pohojnë se e vënë në praktikë kreativitetin dhe 74% pohojnë se kreativiteti i tyre vjen nga vetëdisiplina.

Gjithashtu, 53% e nxënësve të anketuar besojnë se njerëzit janë të mirë dhe ia vlen t'u besosh; 53% e nxënësve mendojnë se ata nuk ndiejnë përgjegjësi për të ndihmuar askënd; dhe 88% e tyre pohojnë se janë të rrethuar nga dashuria sepse japin/falin dashuri.

Mësuesit e intervistuar pohojnë se nxënësi kreativ është *më i përgjegjshëm, ka vetëbesim dhe mund të bëhet një lider. Një nxënës që ka vetëaktualizim, është nxënës që ka arritur në pikën më të lartë të kreativitetit sepse është gjithmonë aktiv në gjithçka ndodh, në shkollë dhe jashtë saj.*

Hulumtimet sugjerojnë çfarë mund të bëjë mësuesi - çdo ditë - për të krijuar kontekstin e duhur në klasë, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe ndërveprimin, po aq sa prirjet individuale;

**Së pari**, ashtu si me kreativitetin, nxënësve duhet t'u kujtohet pritshmëria për bashkëpunim, jo konkurrenca. **Së dyti**, ekziston një gjuhë bashkëpunimi dhe nxënësve duhet t'u mësohet kjo gjuhë, aftësitë që shoqërojnë gjuhën dhe t'u kujtohet të përdorin si gjuhën ashtu edhe aftësitë. Aftësitë specifike për bashkëpunim mund të jenë në dukje sa të thjeshta si; “qëndroni me grupin tuaj” dhe “përdorni zërin e qetë”, aq edhe komplekse si; “kontribuoni të gjithë me ide” ose “kërkoni arsyetim”; Çështja është se këto janë aftësi që mund të mësohen dhe arrihen të mësohen, prandaj është e nevojshme një vëmendje e kujdesshme

ndaj aftësive të tilla. **Së treti**, nxënësve mund t'u kërkohej të artikulojnë ato aspekte të përvojave të tyre bashkëpunuese që kanë qenë interesante dhe të dobishme. Nxënësit duhet të marrin parasysh se si puna dhe idetë e të tjerëve i kanë ndihmuar ata të mësojnë dhe si puna dhe idetë e tyre kanë kontribuar në të kuptuarit dhe kënaqësinë e të tjerëve. **Së katërti**, nxënësit duhet të punojnë brenda një klime të përgjithshme bashkëpunimi. Mësuesit mund të shqyrtojnë mesazhet dhe meta-mesazhet e klasave dhe shkollave të tyre. Nxënësit nuk kanë gjasa të besojnë se bashkëpunimi vlerësohet nëse vlerësimi është normativ, nëse studentët konkurojnë për shpërblime që ata i perceptojnë si të pakta dhe të vlefshme, si dhe nëse vëmendja apo pranimi i mësuesit shihet si i kushtëzuar (Baloche, 2005).

Si ndikojnë teknika të nxënies kreative në vetë-realizimin e nxënësve?

72% e nxënësve pohojnë se mbajnë shënime ose i regjistrojnë idetë e tyre dhe 90% shprehen se lexojnë që të pasurohen me mendime dhe ide, ndërkohë 76% pohojnë se janë të pajisur me mjete gjatë punës së tyre krijuese.

Referuar opinioneve të mësuesve ato pohojnë disa nga faktorët që nxisin kreativitetin si: *“puna në grupe, baza materiale, informacioni, hulumtimi, metoda bashkëkohore. Faktorët që nxisin kreativitetin e nxënësve janë: punët në grupe në klasë, talenti i vetë fëmijes si dhe familja e tyre”*. Po ashtu, përmenden: *“Organizimi i orës së mësimin në mënyrë argëtuese, organizimi i aktiviteteve sportive, projekte, ekskursionet etj. Gjithëpërfshirja e nxënësve në orën e mësimin dhe në aktivitete pavarësisht nga niveli, raca dhe gjendja ekonomike”*.

Përsa i përket pavarësisë së tyre, 70% e nxënësve pohojnë se nuk kanë turp të shprehin emocionet e tyre; 55% shprehen se i pëlqejnë njerëzit, edhe kur nuk janë dakord me ta; ndërkohë vetëm 44% e tyre shprehen se ndihen të lirë me personat që i kanë për zemër.

Sipas mësuesve të intervistuar, *nxënësi kreativ dallohet nga disa cilësi si: zgjuarsia, vullneti, këmbëngulja aktive në çdo gjë që zhvillon shkollën; është i shkathët, ka një ide, i shpreh ato, drejton punën në grup, është organizator*.

Pra, siç vihet re nga gjetjet sasimore dhe cilësore, roli i mësuesit është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e aftësive tek nxënësit dhe promovimin e inteligjencave. Për Davis, Christodoulou, Seider, dhe Gardner (2011: 492), dallimi midis inteligjencës dhe aftësisë është një burim i zakonshëm i konfuzionit. Ndryshe nga sistemet shqisore, të cilat i paraprijnë punës intelektuale, aftësitë manifestohen si produkt i një pune të tillë. Më konkretisht, ato janë performancat kognitive që rezultojnë nga funksionimi i një ose më shumë inteligjencave (Gardner & Moran, 2006). Brenda dhe midis kulturave, llojet e aftësive të shfaqura nga individët ndryshojnë shumë; nga vizatimi i filmave vizatimorë tek noti, nga shkrimi i kodit kompjuterik tek lundrimi i anijeve. Aftësitë veprojnë në botën e jashtme. Si rezultat, ato formohen nga faktorët mbështetës apo kufizues të mjedisit. Kështu, nëse inteligjenca trupore-kinestetike dhe hapësinore e një individi do të përdoret në not ose lundrim detar, varet nga aftësia trupore për të notuar, gatishmëria e instruktorit dhe koha për ta ushtruar në praktikë. Të jetosh në një kulturë që vlerëson aftësinë për të notuar ose lundruar (për të zhytur ose për të kapur peshk) është një tjetër faktor që ndikon.

Sistemet kompjuterike, të nxënësit përmes lojrave kompjuterike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive krijuese, si dhe në aspektet vetërealizuese të tyre. Burlison (2005) konkludon se sot ekziston mundësia për të përdorur të kuptuarit tonë të psikologjisë njerëzore dhe aftësive në inteligjencën

artificiale për të krijuar një sistem hibrid sinergjik të të mësuarit njeri-kompjuter. Edukatorë dhe psikologë të shquar pajtohen se të mësuarit përmirësohet kur ndiqet si një pasion krijues dhe vetëaktualizues. Imajinata, vetëdija metakognitive dhe zhvillimi i perspektivave të shumta janë thelbësore për të kuptuarit e thellë. Kjo çon në zhvillimin e strategjive të brendshme metakognitive të përdoruesve.

Nga opinionet e marra prej mësuesve të fokus-grupit vihet re roli që luan kurrikula në zhvillimin e potencialit krijues. Pavarësisht kësaj, është vetë mësuesi që e bën të prekshme dhe të përshtatshme në klasë. Kjo është kurrikula e brendshme. Për Johnson (2014), një nga gjërat unike në lidhje me kurrikulën e brendshme është se ajo nuk ka nevojë të zëvendësojë një kurrikulë tashmë të vendosur. Ashtu si një dorezë e vogël brenda një doreze më të madhe, ajo mund të shtojë dhe përmirësojë ato gjëra që një mësues aktualisht bën. Aktivitetet në kurrikulën e brendshme mund të përfshijnë inskenime, poezi, shkrim krijues, art, muzikë, vallëzim, arsyesim moral, zgjidhje problemesh, shërbim ndaj komunitetit, libra dhe letërsi, ose thjesht heshtje. Ai sugjeron 8 karakteristika të aktiviteteve që lidhen me këtë kurrikulë, si; të jenë të hapura, të jenë kuptimplote, të lidhen me jetën e nxënësve, të nxisin një kuptim më të madh të vetvetes, të nxisin një kuptim më të madh të individëve të tjerë, të nxisin ndërveprimin dhe ndarjen e ideve, të nxisin mënyra të larmishme për të demonstruar teori dhe të njohin dhe kujdesen për anën shpirtërore të çdo fëmije.

Si përfundim, referuar konteksteve të sotme, mund të themi se diploma të hap derën e punësimit, por janë aftësitë e punës që përcaktojnë produktivitetin dhe kompetencat në përshtatje me teknologjinë dhe oportunitetet e reja.” Sipas teorisë së inteligjencave të shumëfishta, mësuesit duhet të nxisin sa më shumë origjinalitetin tek nxënësit e tyre. Në këtë mënyrë nxënësit jo vetëm do të ishin analizues të mirë, por ajo çka është më e rëndësishmja do të bëhen të aftë të mendojnë për çështje të ndryshme në këndvështrime të ndryshme. Kështu të menduarit, gjuha, lënda mësimore do të përforcojnë njëra-tjetrën. Në epokën e informacionit, nevojat janë shndërruar në të kuptuarin dhe koordinimin e ndryshueshmërisë, kompleksitetit dhe efikasitetit. Mësuesi duhet të përpiqet të njohë anët e forta dhe të dobëta të menduarit të nxënësve të tij, duke i përfshirë në veprimtari të ndryshme që të zgjerojnë shprehitë dhe fjalorin e tyre. Përmes veprimtarive të të menduarit mësuesi do të arrijë t’i bëjë nxënësit të hapen dhe jo të mbyllen. Nxënësi duhet të dalë nga shkolla me më shumë besim në vetvete dhe jo më pak. Identifikimi i vlerave të nxënësve është shumë i rëndësishëm, pasi ky identifikim ushqen ndjesinë e pandalshme të vetërealizimit.

Ndërveprimiu jep mundësi nxënësve, që duke punuar në grupe me njëri tjetrin, të rrisin shkallën e të nxënësve duke shfaqur cilësi të formimit të tyre. Kur flitet për procesin e ndërveprimit në klasë dhe përdorimit të metodave ndërvepruese apo me në qendër nxënësin, është e nevojshme dhe e rëndësishme të flitet për veçoritë e këtij procesi. Metodatat dhe teknikat e të mësuarit duhet të pasqyrohen çdo ditë nga mësuesit në bashkëpunim me nxënësit, për mënyrën e zhvillimit të veprimtarive mësimore, dhe për të arritur qëllimet dhe objektivat mësimore. Kjo kërkon një harmonizim të veprimtarive brenda klasës me botën jashtë saj, ku vlerë më të madhe duhet të kenë veprimtaritë e kryera nga vetë nxënësi. Çdo shkollë, duhet të bëjë vlerësimin, duke u bërë gjykuese; duhet të realizojë sintezën, duke përdorur alternativën sintetizuese; duhet të kryejë analizën duke u bërë analizuese dhe arsyesuese.

Rekomandime për Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore

- T’i pasurojnë vazhdimisht shkollat fillore me qendra të aktiviteteve mësimore.
- Të trajnohen mësuesit për teknika dhe metoda që nxitin nxënësin kreativ.

### Rekomandime për mësuesit

- Aplikimi i temave multidisiplinare, ku të integrohen dhe zbatohen njohuritë.
- Mësuesi t'i nxitë nxënësit në autonominë e tyre, duke i mbështetur sipas nevojave që kanë.
- Të nxitë mësimdhënien ndërvepruese, duke aplikuar teknika të larmishme nxënie.
- Aplikimi i veprimtarive të larmishme, që nxitin inteligjencat e shumfishta, në mënyrë që nxënësit të gjejnë veten në proceset e tyre krijuese.
- Motivimi i vazhdueshëm i nxënësve për të rritur shkallën e tyre të besimit në vetvete.

### Rekomandime për nxënësit

- Nxënësi duhet të ushqejë besimin tek vetja dhe të ndërmarrë detyra sfiduese
- Nxënësi nuk duhet të thyhet para vështirësive apo dështimeve, duke kërkuar alternativa dhe gjetje të reja.
- Nxënësi duhet të gjejë gjuhën e komunikimit me njëri-tjetrin, duke ndarë dijen dhe informacionin.
- Nxënësi duhet ta pranojë veten siç është, duke u përmirësuar vazhdimisht dhe ta ndjejë veten qytetar të mirë dhe të denjë për vendin e tij.

## Referenca

1. Ahmadi, N., & Besançon, M. (2017). Creativity as a stepping stone towards developing other competencies in classrooms. *Education Research International*, 2017.
2. Baloche, L. (2005). Developing cooperative contexts for creativity. *Creative Engagements: Thinking with children*, 53-60.
3. Beghetto, R. A., & Kaufman, J. C. (2014). Classroom contexts for creativity. *High ability studies*, 25(1), 53-69.
4. Goleman, D. (2006). *Emotional Intelligence*. Bantam, New York, 64, 66.
5. Branden, N. (2006). *Healthy Self-Esteem*: [www.nathanielbranden.com](http://www.nathanielbranden.com)
6. Burlison, W. (2005). Developing creativity, motivation, and self-actualization with learning systems. *International Journal of Human-Computer Studies*, 63(4-5), 436-451.
7. Crandall, R., & Jones, A. (1991). Issues in self-actualization measurement. *Journal of Social Behavior and Personality*, 6(5), 339.
8. Davis, K., Christodoulou, J., Seider, S., & Gardner, H. E. (2011). The theory of multiple intelligences. Davis, K., Christodoulou, J., Seider, S., & Gardner, H. (2011). The theory of multiple intelligences. In RJ Sternberg & SB Kaufman (Eds.), *Cambridge Handbook of Intelligence*, 485-503.
9. Emmer, E. T., & Stough, L. M. (2001). Classroom management: A critical part of educational psychology, with implications for teacher education. *Educational Psychologist*, 36(2), 103-112.
10. Fasko, D. (2001). Education and creativity. *Creativity research journal*, 13(3-4), 317-327.
11. Fullan. (2010). *Forcat e ndryshimit*, Tiranë: cde, fq.162.
12. Johnson, A. P. (2014). EDUCATION, SELF-ACTUALIZATION, AND STUDENTS' INNER LIVES. *Theories of Learning and Human Development*.
13. Kaufman, J. C., & Beghetto, R. A. (2013). Do people recognize the four Cs? Examining layperson conceptions of creativity. *Psychology of Aesthetics, Creativity, and the Arts*, 7(3), 229.
14. Maslow, A. H. (1965). *Self-Actualization and Beyond*. Eric, pp. 108-131.
15. Maslow, A. H. (1971). *The farther reaches of human nature* (Vol. 19711). New York: Viking Press.
16. Morais, M. F., & Azevedo, I. (2011). What is a creative teacher and what is a creative pupil? Perceptions of teachers. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 12, 330-339.
17. Rivero, L. (2002). Progressive digressions: Home schooling for self-actualization. *Roeper Review*, 24(4), 197-202.
18. Sullivan, F. R. (2017). *Creativity, technology, and learning: Theory for classroom practice*. Taylor & Francis.
19. Treffinger, D. J. (1986). Research on creativity. *Gifted child quarterly*, 30(1), 15-19.
20. Treffinger, D. J. (1986). Research on creativity. *Gifted child quarterly*, 30(1), 15-19.
21. Zajazi, T. (2003). *Metodologji e Mësimdhënies*. Shkup: VINSENT GRAPHIC. fq. 476.